

VENDIM
Nr. 807, datë 16.11.2016
PËR DISIPLINIMIN E ANGAZHIMEVE BUXHETORE¹
(Ndryshuar me VKM nr.591, datë 18.10.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 16, 40 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.

2. Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës.

3. Kufizimit kohor të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, nuk i nënshtrohen:

- a) fondet e akorduara nëpërmjet rishikimit të ligjit vjetor të buxhetit;
- b) fondet e akorduara me vendim të Këshillit të Ministrave nga fondi rezervë dhe/ose fondi i kontingjencës, për raste emergjente/të papa-rashikuara;
- c) fondet e akorduara me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve;
- ç) fondet e rialokuara për kryerjen e një investimi/shërbimi, në zbatim të detyrimeve të parashikuara me ligj të ri;
- d) prokurimet për shërbimin e ushqimit dhe /ose të medikamenteve, në ato njësi të qeverisjes së përgjithshme që i administrojnë këto shërbime;
- dh) prokurimet me vlerë të vogël, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në rastet kur, fondet buxhetore për to janë të parashikuara në buxhetin e vitit korrent të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe janë pjesë e regjistrit të prokurimeve publike.

e) fondet e shpërndara me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin 2017.

4. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësisive të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr.807, datë 16.11.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.229, 24 nëntor 2016.
VKM nr.591, datë 18.10.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, 24 tetor 2017.